



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KOLONJË
NJËSIA E PROKURIMIT

(Njësia e Prokurimit e ngritur me urdhrin e titullarit të autoritetit kontraktor nr. **96**, datë **12.02.2024**)

Nr _____ Prot

Kolonjë më ____ / ____ / 2024

PROCES-VERBAL – Tipi i kontratës - Mall
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky proces-verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot më datë **26.02.2024**, në **Bashkinë Kolonjë**, nga Njësia e Prokurimit, e përcaktuar në urdhrin nr. **96** dhe nr. **796** prot ,datë **12.02.2024**, të titullarit të autoritetit kontraktor në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme:

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje karburant GAZOIL 10 ppm dhe Benzine (Premium Unl 10 ppm) diferencë për vitin 2024 ,vitin 2025 dhe vitin 2026, i ndarë në lote:

Loti nr.1 Blerje karburant GAZOIL (10 ppm ULSD) diferencë për vitin **2024** ,vitin **2025** dhe vitin **2026**,

Loti nr.2 Blerje karburant Benzine (Premium Unl 10 ppm) diferencë për vitin **2024** ,vitin **2025** dhe vitin **2026**.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09132000-3 - Benzinë, 09134000-7 – Naftë

VLERA E FONDIT LIMIT: 58,333,333.33 (Pesëdhjetëetëtmilionetreqindetridhjetëetremijëe treqindetridhjetëetrepikëtridhjetëetë) **lekë pa tvsh**, ose **561,761.6** (Pesëqindëgjashtëdhjetëenjëmijë e shtatëqindëgjashtëdhjetëenjë pikë gjashtë) **Euro pa tvsh**.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 26/02/2024 është 103.84 Lekë/ Euro

Loti nr.1 Blerje karburant GAZOIL (10 ppm ULSD) diferencë për vitin 2024 ,vitin 2025 dhe vitin 2026,me fond limit **58,000,000** (Pesëdhjetëetëtmilion) **lekë pa tvsh** ose **558,551.6** (Pesëqindëpesëdhjetë e tetëmijëepesëqindëpesëdhjetëenjë pikë gjashtë) **Euro pa tvsh**.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 26/02/2024 është 103.84 Lekë/ Euro

Loti nr.2 Blerje karburant Benzine (Premium Unl 10 ppm) diferencë për vitin 2024 ,vitin 2025 dhe vitin 2026,me fond limit **333,333.33** (**Treqindetridhjetëetremijëetreqindetridhjetëetrepikëtridhjetëetë**) **lekë pa tvsh** ose **3,210** (Tremijëedyqindëdhjetë) **Euro pa tvsh**.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 26/02/2024 është 103.84 Lekë/ Euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kolonjë** ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti nr.1

Blerje karburant GAZOIL (10 ppm ULSD) diferencë për vitin 2024 ,vitin 2025 dhe vitin 2026.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhës te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020-2021-2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet Loti I**.

Nëse një operator ekonomik konkuron për të **2 (dy) Lotet** së bashku duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të loteve të marra së bashku për të cilat ofertuesi konkurren.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në **nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”**, ku parashikohet se: *“Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”.*

si dhe bazuar në **nenin 43, pika 2/a, nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, parashikohet se:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet **të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet Loti I** dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020-2021-2022**, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur operatorët ekonomik ofertues janë në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika c, e ligjit nr.10091, datë.05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel. **Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet **për vitin 2023** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore **dhe për vitin e fundit 2024 (këstet e maturuara).**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, **në një vlerë jo më të madhe se 40%** të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet **Loti I**, të realizuar gjatë tri viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**.

Nëse një operator ekonomik konkuron për të **2 (dy) Lotet** së bashku, duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, furnizime të mëparshme të ngjashme, **në një vlerë jo më të madhe se 40%** e fondit limit të loteve të marra së bashku për të cilat ofertuesi konkurren.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin **77** të ligjit nr. **162/2020**, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit **40**, pika **4**, të VKM nr. **285**, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë **në një vlerë jo më të madhe se 40%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vërtetuar eksperiencën e operatoreve ekonomikë ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses.

2.3.2 Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë/in liçensat përkatëse **për tregtimin me pakicë të karburanteve**, gazit të lëng-shëm të naftës, **për automjetet**, vajrave lubrifikant edhe lëndëve djegëse **për përdorim nga konsumatorët fundorë**.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/a, pika 7/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë liçensat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës ç’ka bën operatorin ekonomik fitues me të përgjigjshëm për produktet që oferton.

2.3.3/a Operatori/et Ekonomik duhet të ketë minimalisht **1 (një) pikë** stacioni të shitjes së karburanteve me pakicë në Bashkinë Kolonjë të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose kontratë qeraje ose kontratë furnizimi,ku të jetë e përcaktuar adresa e saktë.

2.3.3/b Operatori/et Ekonomik duhet të deklarojnë se në rast se shpallen fitues do ti sigurojnë autoritetit kontraktor minimalisht një pikë furnizimi në secilin prej Qarqeve si më poshtë: Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan dhe Korçë. Për të përmbushur këtë kërkesë operatorët duhet të vërtetojnë përmes një marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe furnizuesit, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si:Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo pas kërkesës së Autoritetit Kontraktor për furnizimin e nevojshëm.

Stacionet e tregimit me pakicë të karburanteve të cituara me lartë detyrimisht duhen të jenë të pajisur:

- Autorizim lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë,
- Leje mjedisore përkatëse lëshuar nga QKL,
- Çertifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjit Nr.8450 datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregëtimin e Naftës, të Gazit dhe nën produkteve të tyre”, i ndryshuar, nenin 20 “Autorizimet”, dhe Kreu për dhenien e licencave për tregtim me pakice.

Njësia e Prokurimit, për mos ta kufizuar këtë kriter ka gjykuar dhe ka kërkuar si alternativë një nga format e disponimit sipas Kodit Civil për këto stacione, ku përveç **kontratës së qirasë ose aktit të pronësisë** ka kërkuar edhe **kontratë furnizimi** ku të jetë e përcaktuar adresa e saktë.Gjykojmë se një nga format e mësipërme, garanton marrjen e një produkti me cilësi dhe u arsyetuan të nevojshme për të siguruar ofertues serioz, të formalizuar dhe zbatues korrekt të kërkesave ligjore për trajtimin e karburanteve në sasi dhe cilësi për pikat e stacioneve të përcaktuara.

Lista e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë, sipas adresave të kërkuara nga **Bashkia Kolonjë** janë kërkuar sipas Qarqeve në të cilën autoriteti kontraktor , ushtron aktivitetin e saj .

Autorizim lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë është kërkuar në përputhje me Ligjin nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin,transportimin dhe tregëtimin e Naftës,Gazit dhe nëprodukteve të tyre” për përdorim nga konsumatorët fundorë si dhe v.k.m nr.563 datë.27.08.2004 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e Naftës,Gazit dhe nëprodukteve të tyre” që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit për përdorim rezidencial.

Leje mjedisore përkatëse lëshuar nga QKL, është kërkuar në mënyrë që OE të ketë aftësinë teknike për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrotjes së mjedisit në tërësi dhe shëndetit.Çertifikatë e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH është e rëndësishëm pasi tregon që operatori ekonomik ofertues ka marrë masa dhe vepron në përputhje me legjislacion Shqiptar.

2.3.4 Operatori/et Ekonomik duhet të detyrimisht duhet të paraqes/in Fletë analizë të lëshuar nga Inspektoriati Shtetror Teknik dhe industrial “ISHTI” të shoqëruar me vërtetim teknik të ISHTI-së ose nga një laborator i çertifikuar në Republikën e Shqipërisë .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Referuar ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregëtimin e Naftës, të Gazit dhe nën produkteve të tyre”, i ndryshuar, Shoqëritë e tregimit me shumicë të naftës dhe nën produkteve të saj, ashtu edhe stacionet e shitjes së karburanteve, i nënshtohen kontrollit periodik të standarteve teknike të naftës dhe nën produkteve të saj, e rrjedhimisht OE kane detyrimin që të paraqesin fletë analizat të lëshuar nga ISHTI për produktet që do të ofrojë.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratat si mëposhtë:

- Operatori/et Ekonomik duhet të deklarojë/në, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, me tollon letër në formë biletash ose bot sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Operatori/et Ekonomik duhet të deklarojë/në se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori/et Ekonomik duhet të deklarojë/në se merr përsipër që të konvertoje të gjithë sasinë e litrave të tollonave letër në formë biletash në leng me bot, deri në perfundimin e plotë të kontrates, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Tollonat letër duhet të jenë pa skadence dhe të jenë të përdorshme dhe gjatë vitit **2027**.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponueshmërinë e tyre për furnizimin me karburant në vendet e përcaktuara nga AK sipas kërkesave të tij në funksion të mbarëvajtjes së proceseve të punës.

2.3.6 Operatori/et Ekonomik duhet të ketë-në në pronësi ose me qera **1 (një) autobot** të posaçëm për transport të lëndëve të rrezikshme së bashku me aparatin matës (kondralitër).Autoboti do të shërbejë për transportin e karburantit në vendin ku ndodhen depozitat dhe mjetet e tonazhit të rendë të autoritetit kontraktor.

Autoboti duhet të jetë i pajisur me Leje Qarkullimi (në rastet kur janë në pronësi) ose kontratën e vlefshme të qerave + leje qarkullimi (në rastet e marrjes me qera) si dhe Çertifikatën e Kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit dhe pasaportën e mjetit. Automjeti të ketë të vendosur kontalitrin e kalibruar dhe certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë të vërtetuar me çertifikatën e lëshuar nga kjo drejtori. Për arsye të vendodhjes së depozitave dhe mjeteve të tonazhit të rendë të autoritetit kontraktor dhe vështirësisë në rastet e furnizimit autoboti duhet të ketë vëllim jo më të madh se 1000 (njemijë) litra.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu janë përcaktuar në funksion të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë së mallit objekt prokurimi, aftësisë dhe zotërimit të aseteve të nevojshme fizike (mjete transporti/autobote) të operatorit ekonomik për të realizuar furnizimin e mallit (karburant) në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara. Vetë natyra dhe rëndësia e veçantë e artikullit objekt prokurimi kërkon garancinë dhe vëmendjen e duhur si nga AK ashtu dhe nga operatorët ekonomik pjesëmarrës.

2.3.7 Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in një vertetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standarteve të legjislationit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin **2023** dhe deri në datën e hapjes se ofertave .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të paraqes-in certifikatën e meposhtme:

- ✓ Çertifikate për sistemin e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015**/ ose ekuivalente, (e vlefshme) e cila të përfshijë objektin e prokurimit .
- ✓ Çertifikatë **ISO 14001-2015** / ose ekuivalente, (e vlefshme) e cila të përfshijë objektin e prokurimit .

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqes këto certifikata (ose ekuivalente) (të vlefshme), në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes të zërave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë.23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2.3.9 Bashkia Kolonjë rezervon të drejtën që kur e gjykon të nevojshme të kërkojë kontrollin e cilësisë së karburantit. Deklaratë për shpenzimet e kontrollit të cilësisë të përballohen nga operatori ekonomik.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni i ngritur me urdhër nr.**95** me nr.**795** prot, datë.**12.02.2022** duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt prokurimi, duke përlllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sasia e pritshme dhe fondi limit janë përgatitur nga komisioni i ngritur me urdhër nr.**95** me nr.**795** prot, datë.**12.02.2022**, bazuar në fondet e planifikuar në buxhetin e bashkisë për vitin **2024, 2025** dhe **2026** si dhe çmimin e publikuar nga agjensia e prokurimit publik në buletin nr. **Nr. 11** datë.**26 Shkurt 2024** dhe kursin e këmbimit të bankës së shqipërisë datë.**26.02.2024**.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **28.03.2024, ora 11:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt, “**Loti nr.1 Blerje karburant GAZOIL (10 ppm ULSD) diferencë për vitin 2024 ,vitin 2025 dhe vitin 2026**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali: Dokumentat e tenderit, Preventivi, Specifikimet teknike.

Loti nr.2

Loti nr.2 Blerje karburant Benzine (Premium Unl 10 ppm) diferencë për vitin 2024 ,vitin 2025 dhe vitin 2026.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020-2021-2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **në një vlerë jo më të madhe se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet Loti II** .

Nëse një operator ekonomik konkurron për të **2 (dy) Lotet** së bashku duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të loteve të marra së bashku për të cilat ofertuesi konkurron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin **77**, pika **3**, e LPP, si dhe nenin **43**, pika **2/c** të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në **nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”**, ku parashikohet se: *“Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”.*

si dhe bazuar nënenin **43, pika 2/c, nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, parashikohet se:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet **të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet Loti II** dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”* pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020-2021-2022**, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur operatorët ekonomik ofertues janë në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika c, e ligjit nr.10091, datë.05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel. **Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet **për vitin 2023** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore **dhe për vitin e fundit 2024 (këstet e maturuara).**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.4 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, **në një vlerë jo më të madhe se 20 %** të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet **Loti II**, të realizuar gjatë tri viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Nëse një operator ekonomik konkuron për të **2 (dy) Lotet** së bashku, duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, furnizime të mëparshme të ngjashme, **në një vlerë jo më të madhe se 40 %** e fondit limit të loteve të marra së bashku për të cilat ofertuesi konkurren.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë **në një vlerë jo më të madhe se 40 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vërtetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses.

2.3.2 Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in licencat përkatëse **për tregtimin me pakicë të karburanteve**, gazit të lëng-shëm të naftës, **për automjetet**, vajrave lubrifikant edhe lëndëve djegëse **për përdorim nga konsumatorët fundorë.**

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/a, pika 7/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës ç’ka bën operatorin ekonomik fitues me të përgjigjshëm për produktet që oferton.

2.3.3/a Operatori/et Ekonomik duhet të ketë minimalisht **1 (një) pikë** stacioni të shitjes së karburanteve me pakicë në Bashkinë Kolonjë të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose kontratë qeraje ose kontratë furnizimi,ku të jetë e përcaktuar adresa e saktë.

2.3.3/b Operatori/et Ekonomik duhet të deklarojnë se në rast se shpallen fitues do ti sigurojnë autoritetit kontraktor minimalisht një pikë furnizimi në secilin prej Qarqeve si më poshtë: Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan dhe Korçë. Për të përmbushur këtë kërkesë operatorët duhet të vërtetojnë përmes një marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe furnizuesit, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si:Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo pas kërkesës së Autoritetit Kontraktor për furnizimin e nevojshëm.

Stacionet e tregimit me pakicë të karburanteve të cituara me lartë detyrimisht duhen të jenë të pajisur:

- Autorizim lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë,
- Leje mjedisore përkatëse lëshuar nga QKL,
- Çertifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjit Nr.8450 datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregëtimin e Naftës, të Gazit dhe nën produkteve të tyre”, i ndryshuar, nenin 20 “Autorizimet”, dhe Kreu për dhenien e licencave për tregtim me pakice.

Njësia e Prokurimit, për mos ta kufizuar këtë kriter ka gjykuar dhe ka kërkuar si alternativë një nga format e disponimit sipas Kodit Civil për këto stacione, ku veë kontratës së qirasë ose aktit të pronësisë ka kërkuar edhe kontratë furnizimi ku të jetë e përcaktuar adresa e saktë.Gjykojmë se një nga format e mësipërme, garanton marrjen e një produkti me cilësi dhe u arsyetuan të nevojshme për të siguruar ofertues serioz, të formalizuar dhe zbatues korrekt të kërkesave ligjore për trajtimin e karburanteve në sasi dhe cilësi për pikat e stacioneve të përcaktuara.

Lista e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë, sipas adresave të kërkuara nga **Bashkia Kolonjë** janë kërkuar sipas Qarqeve në të cilën autoriteti kontraktor , ushtron aktivitetin e saj .

Autorizim lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë është kërkuar në përputhje me Ligjin nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin,transportimin dhe tregëtimin e Naftës,Gazit dhe nëprodukteve të tyre” për përdorim nga konsumatorët fundorë si dhe v.k.m nr.563 datë.27.08.2004 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e Naftës,Gazit dhe nëprodukteve të tyre” që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit për përdorim rezidencial.

Leje mjedisore përkatëse lëshuar nga QKL, është kërkuar në mënyrë që OE të ketë aftësinë teknike për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrotjes së mjedisit në tërësi dhe shëndetit.Çertifikatë e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH është e rëndësishëm pasi tregon që operatori ekonomik ofertues ka marrë masa dhe vepron në përputhje me legjislacion Shqiptar.

2.3.4 Operatori/et Ekonomik duhet të detyrimisht duhet të paraqes/in Fletë analizë të lëshuar nga Inspektoriati Shtetror Teknik dhe industrial “ISHTI” të shoqëruar me vërtetim teknik të ISHTI-së ose nga një laborator i çertifikuar në Republikën e Shqipërisë .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Referuar ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregëtimin e Naftës, të Gazit dhe nën produkteve të tyre”, i ndryshuar, Shoqëritë e tregimit me shumicë të naftës dhe nën produkteve të saj, ashtu edhe stacionet e shitjes së karburanteve, i nënshtohen kontrollit periodik të standarteve teknike të naftës dhe nën produkteve të saj, e rrjedhimisht OE kane detyrimin që të paraqesin fletë analizat të lëshuar nga ISHTI për produktet që do të ofrojë.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratat si mëposhtë:

- Operatori/et Ekonomik duhet të deklarojë/në, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, me tollon letër në formë biletash ose bot sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Operatori/et Ekonomik duhet të deklarojë/në se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori/et Ekonomik duhet të deklarojë/në se merr përsipër që të konvertoje të gjithë sasinë e litrave të tollonave letër në formë biletash në leng me bot, deri në perfundimin e plotë të kontrates, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Tollonat letër duhet të jenë pa skadence dhe të jenë të përdorshme dhe gjatë vitit **2027**.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponueshmërinë e tyre për furnizimin me karburant në vendet e përcaktuara nga AK sipas kërkesave të tij në funksion të mbarëvajtjes së proceseve të punës.

2.3.6 Operatori/et Ekonomik duhet të ketë-në në pronësi ose me qera **1 (një) autobot** të posaçëm për transport të lëndëve të rrezikshme së bashku me aparatin matës (kondralitër).Autoboti do të shërbejë për transportin e karburantit në vendin ku ndodhen depozitat dhe mjetet e tonazhit të rendë të autoritetit kontraktor.

Autoboti duhet të jetë i pajisur me Leje Qarkullimi (në rastet kur janë në pronësi) ose kontratën e vlefshme të qerave + leje qarkullimi (në rastet e marrjes me qera) si dhe Çertifikatën e Kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit dhe pasaportën e mjetit. Automjeti të ketë të vendosur kontalitrin e kalibruar dhe certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë të vërtetuar me çertifikatën e lëshuar nga kjo drejtori. Për arsye të vendodhjes së depozitave dhe mjeteve të tonazhit të rendë të autoritetit kontraktor dhe vështirësisë në rastet e furnizimit autoboti duhet të ketë vëllim jo më të madh se 1000 (njemijë) litra.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu janë përcaktuar në funksion të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë së mallit objekt prokurimi, aftësisë dhe zotërimit të aseteve të nevojshme fizike (mjete transporti/autobote) të operatorit ekonomik për të realizuar furnizimin e mallit (karburant) në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara. Vetë natyra dhe rëndësia e veçantë e artikullit objekt prokurimi kërkon garancinë dhe vëmendjen e duhur si nga AK ashtu dhe nga operatorët ekonomik pjesëmarrës.

2.3.7 Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in një vertetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standarteve të legjisllacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin **2023** dhe deri në datën e hapjes se ofertave .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të paraqes-in certifikatën e meposhtme:

- ✓ Çertifikate për sistemin e menaxhimit te cilësisë **ISO 9001:2015/** ose ekuivalente, (e vlefshme) e cila të përfshijë objektin e prokurimit .
- ✓ Çertifikatë **ISO 14001-2015** / ose ekuivalente, (e vlefshme) e cila të përfshijë objektin e prokurimit .

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese këto certifikata (ose ekuivalente) (të vlefshme),në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes të zërave që do të marrë përsipër të realizoje sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë.23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2.3.9 Bashkia Kolonjë rezervon të drejtën që kur e gjykon të nevojshme të kërkojë kontrollin e cilësisë së karburantit.Deklaratë për shpenzimet e kontrollit të cilësisë të përballohen nga operatori ekonomik.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni i ngritur me urdhër nr.95 me nr.795 prot, datë.12.02.2022 duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sasia e pritshme dhe fondi limit janë përgatitur nga komisioni i ngritur me urdhër nr.95 me nr.795 prot, datë.12.02.2022, bazuar në fondet e planifikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2024, 2025 dhe 2026 si dhe çmimin e publikuar nga agjensia e prokurimit publik në buletin nr. Nr. 11 datë.26 Shkurt 2024 dhe kursin e këmbimit të bankës së shqipërisë datë.26.02.2024.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **28.03.2024, ora 11:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt, “**Loti nr.2 Blerje karburant Benzine (Premium Unl 10 ppm) diferencë për vitin 2024 ,vitin 2025 dhe vitin 2026**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali:Dokumentat e tenderit,Preventivi,Specifikimet teknike.

Njësia e Prokurimit

Person përgjegjës për prokurimin publik

Anëtare

Anëtar